



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2020:001050
Datë: 03.04.2024
Numri i dokumentit: 05539090

E.nr.550/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përmbartimore të kreditorëve: F.S., H.H., H.V., I.I dhe I.Ç., të cilët i përfaqëson av Arian Hetemi nga Lipjani, kundër debitorit Komuna e Ferizajt - Drejtorja e Arsimit, për pagesën e ushqimit, shpenzimet e udhëtimit, shpërblimit jubilar, si dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 02.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbartimore në lëndën **E.nr.550/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorëve.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.550/23, të datës 23.03.2023, e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorëve, kundër debitorit Komuna e Ferizajt - Drejtorja e Arsimit, për pagesën e ushqimit, shpenzimet e udhëtimit, shpërblimi jubilar dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të aktgjykimit C.nr.40/20, të datës 23.03.2021.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbartimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 15.09.2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 10,605.46 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorëve.

Meqenëse kreditorët e kanë realizuar kërkesën e tyre, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbartimore në këtë çështje juridike përmbartimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.550/23, më datë 02.04.2024

GJYQTARI
Faton Ajvazi